



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.1039/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit “P...”, Sh.p.k., Zona Industriale Prishtinë – Fushë Kosovë, përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, kundër të paditurit K.S. “B....” Sh.p.k., me adresë në rrugën “...”, nr...., Prishtinë, me objekt kontesti pagesë borxhi, jashtë seancës, me datë 20.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit “P...”, Sh.p.k., me numër KE.nr.1039/22 (II.EK.nr.249/2018), e datës 24.04.2018, me objekt kontesti pagesën e borxhit, ndaj të paditurit K.S. “B....” Sh.p.k.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi “P...”, Sh.p.k., Zona Industriale Prishtinë – Fushë Kosovë, me datën 24.04.2018, ka parashtruar padi për pagesën e borxhit, kundër të paditurit K.S. “B....” Sh.p.k., me adresë në rrugën “...”, nr., Prishtinë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me datën 03.06.2022, me anë të parashtresës, e ka njoftuar gjykatën se palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje, andaj paditësi ka kërkuar që padia e ushtruar ndaj të paditurës K.S. “B....” Sh.p.k., të tërhiqet.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, në kuptim të nenit 261 dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Ekonomike
KE.nr. 1039/22, datë 20.09.2022.

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.